



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1284/7 prot.

Datë 26.05.2026

V E N D I M

Nr.712/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “REJ” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-82307-04-16-2026, me objekt: “Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” me fond limit 108,236,213.88 lekë (pa tvsh), planifikuar për tu zhvilluar me datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Rej” SHPK me NIPT J93711608Q dhe adresë: Rruga Dritan Hoxha, Ngjitur me Shkollen Ahmet Gashi, Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, H, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.04.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-82307-04-16-2026, me objekt: “Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” me fond limit 108,236,213.88 lekë (pa tvsh), planifikuar për tu zhvilluar me datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 27.04.2026, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankimi elektronik nr.A/2026/6588, protokolluar me nr. 1284/2026 prot., datë 27.04.2026 i operatorit ekonomik “Rej” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 05.05.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin nr.67/2026, datë 04.05.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, protokolluar me tonën me nr.1284/1 prot., datë 05.05.2026, lidhur me shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK .

II.5.Vendimin nr.67/2026, datë 04.05.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, autoriteti kontraktor e ka përcjellë edhe përmes shërbimit postar protokolluar me tonën me nr.1284/2 prot., datë 07.05.2026.

II.6. Referuar vendimit nr.67/2026, datë 04.05.2026 të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, si më poshtë:

[....]

II.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit "REJ" shpk mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, konkretisht heqjen e kërkesës 2.3.7me argumentimin se: "...Në Formularin e Specifikimeve Teknike por dhe në Formularin e Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit nuk është parashikuar asnjë zë shërbimesh që ka të bëjë me vendosje të jo më pak se 20 tualete portative të përshtatshme për instalimin dhe stacionimin në zona bregdetare në përputhje me standartin SSH UNI DIN EN 16194 ose ekuivalent, fakt që kriterin e pikës 2.3.7 të DT-ve e bën plotësisht të paligjshëm...", KSHA arsyeton se:

... KSHA argumenton se referuar legjislacionit për prokurimin publik në fuqi kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës si dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. Këto kriteret duhet të jenë të përcaktuara në mënyrë të tillë që t'u mundësojnë Operatorëve ekonomik pjesëmarrës përgatitjen e ofertave në mënyrë sa më të krahaseshme.

Gjithashtu Kriteret e Veçanta për Kualifikim shërbejnë që Autoriteti Kontraktor të njihet me gjendjen dhe kapacitetet reale të Operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të natyrës dhe llojit të kontratës, Autoriteti Kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim Dokumentet e Tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, konstaton se në Formularin e Specifikimeve Teknike (Shtojca 6) nuk është parashikuar asnjë specifikim tekniko-funksional apo kërkesë operative apo metodologji në lidhje me tualetet portative. Gjithashtu dhe në Grafikonin e Ekzekutimit të Shërbimeve (Shtojca 7) nuk evidentohet asnjë zë shërbimi që lidhet me instalimin, stacionimin apo mirëmbajtjen e tualeteve portative nëpër zonat bregdetare.

Ndodhur në të tilla kushte, KSHA gjykon se kërkesa për disponimin e jo më pak se 20 tualeteve portative nuk lidhet drejtpërdrejtë me objektin e kontratës, e si rrjedhojë nuk justifikon as teknikisht dhe as ligjërisht nevojën konkrete të përcaktuar në objektin e prokurimit.

Për më tepër, nga ana praktike mungesa e përcaktimeve teknike dhe operative e bën të pamundur për Operatorët ekonomik pjesëmarrës identifikimin dhe vlerësimin e saktë të kostos si dhe përfshirjen e këtij elementi në ofertë.

Kërkesa për disponimin e jo më pak se 20 tualete portative të përshtatshme për instalimin dhe stacionimin në zona bregdetare në përputhje me standartin SSH UNI DIN EN 16194 ose ekuivalent, përbën një kufizim të pajustificuar të konkurrencës dhe bie ndesh me parimet e transparencës, barazisë në trajtim dhe proporcionalitetit, pasi referuar Dokumentet e Tenderit të publikuara në SPE në lidhje me procedurën e prokurimit objekt i këtij ankimi, kjo kërkesë nuk është reflektuar as në specifikimet teknike as në zërat e shërbimit.

Për këtë arsye, KSHA gjykon se me qëllim mundësimin e një gare të rregullt si me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës ndërmjet Operatorëve ekonomik, kërkesa e implementuar në DT, kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.7 duhet të hiqet.

Per sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit "REJ" shpk mbi modifikimin e Dokumentet e Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.2 me argumentimin se: Nisur nga zërat e shërbimeve të prokuruar dhe të kërkuara në dokumentet e tenderit nuk është kërkuar të kryhet shërbimi i mbetjeve të bidegradueshme nga kuzhinat dhe mensat sipas kodit 6-shifror 20 01 08; nuk është kërkuar të kryhet shërbimi i mbetjeve të biodegradueshme sipas kodit 20 02 01 si

dhe nuk është kërkuar kryerja e heqjes së llumrave nga gropat skeptike sipas kodit 20 03 04...", KSHA arsyeton se:...

Duke qenë se kërkesa për disponimin e jo më pak se 20 tualeteve portative është vlerësuar si e pajustifikuar dhe e palidhur me objektin e kontratës, KSHA argumenton se për të njëjtat arsye rezultoni e pajustifikuar edhe kërkesa për disponimin e kodit **20 03 04** në licensën III.2.B lëshuar nga QKB.

Për këtë arsye, me qëllim garantimin e një gare të rregullt dhe nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomike, Komisioni gjykon se kërkesa e parashikuar në Dokumentet e Tenderit, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.2 në lidhje me disponimin e kodit 20 03 04 në licensën III.2.B, duhet të hiqet.

Per sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

II.6. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.6, KSHA vëren se:..

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues se: "...Kërkesa për disponimin e 2 (dy) autohote uji i pajisur me pompe thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të ozionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës 2,000-3,000 litra; - 1 (një) autobot uji i pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompe lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 1,000 litra nuk është proporcion të drejtë me objektin e kontratës, pasi referuar zërave të shërbimeve të kërkuara nuk parashikohet askund as si shërbim në specifikime por as dhe si zë për ofertim pastrimi i tualeteve portative, thithje me vakum apo pastrim me pompë lavazhi i tualeteve portative...", KSHA gjykon se:

Referuar legjislacionit për prokurimin publik në fuqi kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës si dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. Këto kritere duhet të jenë të përcaktuara në mënyrë të tillë që t'u mundësojnë Operatorëve ekonomik pjesëmarrës përgatitjen e ofertave në mënyrë sa më të krahasueshme. Gjithashtu kriteret e veçanta për kualifikim shërbejnë që Autoriteti Kontraktor të njihet me gjendjen dhe kapacitetet reale të Operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të natyrës dhe llojit të kontratës, Autoriteti Kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim Dokumentet e Tenderit të publikuara për procedurën objekt ankimi, konstatoi se në Formularin e Specifikimeve Teknike (Shtojca 6) nuk është parashikuar asnjë specifikim tekniko-funksional, kërkesë operative apo metodologji në lidhje me tualetet portative. Gjithashtu, në Grafikonin e Ekzekutimit të Shërbimeve (Shtojca 7) nuk

është evidentuar asnjë zë shërbimi që lidhet me instalimin, stacionimin apo mirëmbajtjen e tyre në zonat bregdetare.

Në këto kushte, duke qenë se kërkesa për disponimin e jo më pak se 20 tualeteve portative është vlerësuar si e pajustificuar dhe e palidhur me objektin e kontratës, KSHA argumenton se për të njëjtat arsye rezultojnë e pajustificuar edhe kërkesa për disponimin e mjeteve mbështetëse për funksionimin e tyre, konkretisht kërkesa e parashikuar në DT për disponimin e:

2 (dy) autobote uji i pajisur me pompe thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës 2,000-3,000 litra;

1 (një) autobus uji i pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 1,000.

Për këtë arsye, me qëllim garantimin e një gare të rregullt dhe nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, Komisioni gjykon se kërkesa e parashikuar në Dokumentet e Tenderit, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.6 në lidhje me mjetet autobus uji të pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrim /dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre duhet të hiqet.

Per sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

II.7. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.4, me arsyetimin se:

"...Numri i kërkuar i shoferave nuk është në përpjestim të drejtë me numrin e mjeteve të kërkuara në pikën 2.3.6 dhe për këtë arsye duhet të modifikohet në përputhje me mjetet e kërkuara..." KSHA gjykon se:...

Ndodhur në kushtet ku KSHA ka argumentuar heqjen e kërkesës së parashikuar në DT në lidhje me mjetet autobus uji të pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, argumentojmë se Autoriteti Kontraktor duhet të rishikojë dhe njëherë kërkesën në lidhje me numrin e punonjësve shoferë, në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet modifikimit në lidhje me mjetet e kërkuara.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", (1 ndryshuar), dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik "REJ" shpk....

II.7.Me shkresën nr.1284/3 prot., datë 13.05.2026, me objekt:Kërkesë për paraqitje dokumentacioni”, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacionin si më poshtë: [...] *Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me përlllogaritjen analitike për fuqinë punëtore dhe përlllogaritjen analitike për mjetet e kërkuara, mbi bazën e preventivit dhe grafikut të realizimit të shërbimit, të njehsuara me origjinalin dhe të numerizuara nga ana e autoritetit tuaj kontraktor.*

II.8.Me shkresën nr.1844/13 prot., datë 21.05.2026, me objekt ”Mbi dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” ndarë në lote”, protokolluar me tonën me nr.1284/4 prot. datë 25.05.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 1844/9 prot., datë 05.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1284/1 prot., datë 06.05.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së nga operatori ekonomik “Rej” SHPK lidhur me dokumentat e tenderit, në procedurën e prokurimit me Nr. REF-82307-04-16-2026, me objekt: “Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik Vendimin nr.67/2026, datë 04.05.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Referuar vendimit nr.67/2026, datë 04.05.2026 të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, si më poshtë:

[....]

II.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit "REJ" shpk mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, konkretisht heqjen e kërkesës 2.3.7 me argumentimin se: "...Në Formularin e Specifikimeve Teknike por dhe në Formularin e Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit nuk është parashikuar asnjë zë shërbimesh që ka të bëjë me vendosje të jo më pak se 20 tualete portative të përshtatshme për instalimin dhe stacionimin në zona bregdetare në përputhje me standartin SSH UNI DIN EN 16194 ose ekuivalent, fakt që kriterin e pikës 2.3.7 të DT-ve e bën plotësisht të paligjshëm...", KSHA arsyeton se:

... KSHA argumenton se referuar legjislacionit për prokurimin publik në fuqi kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës si dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. Këto kriteret duhet të jenë të përcaktuara në mënyrë të tillë që t'u mundësojnë Operatorëve ekonomik pjesëmarrës përgatitjen e ofertave në mënyrë sa më të krahasueshme.

Gjithashtu Kriteret e Veçanta për Kualifikim shërbejnë që Autoriteti Kontraktor të njihet me gjendjen dhe kapacitetet reale të Operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të natyrës dhe llojit të kontratës, Autoriteti Kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim Dokumentet e Tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, konstaton se në Formularin e Specifikimeve Teknike (Shtojca 6) nuk është parashikuar asnjë specifikim tekniko-funksional apo kërkesë operative apo metodologji në lidhje me tualetet portative. Gjithashtu dhe në Grafikon e Ekzekutimit të Shërbimeve (Shtojca 7) nuk evidentohet asnjë zë shërbimi që lidhet me instalimin, stacionimin apo mirëmbajtjen e tualeteve portative nëpër zonat bregdetare.

Ndodhur në të tilla kushte, KSHA gjykon se kërkesa për disponimin e jo më pak se 20 tualeteve portative nuk lidhet drejtpërdrejtë me objektin e kontratës, e si rrjedhojë nuk justifikon as teknikisht dhe as ligjërisht nevojën konkrete të përcaktuar në objektin e prokurimit.

Për më tepër, nga ana praktike mungesa e përcaktimeve teknike dhe operative e bën të pamundur për Operatorët ekonomik pjesëmarrës identifikimin dhe vlerësimin e saktë të kostos si dhe përfshirjen e këtij elementi në ofertë.

Kërkesa për disponimin e jo më pak se 20 tualeteve portative të përshtatshme për instalimin dhe stacionimin në zona bregdetare në përputhje me standartin SSH UNI DIN EN 16194 ose ekuivalent, përbën një kufizim të pajustificuar të konkurrencës dhe bie ndesh me parimet e transparencës, barazisë në trajtim dhe proporcionalitetit, pasi referuar Dokumenteve të Tenderit të publikuara në SPE në lidhje me procedurën e prokurimit objekt i këtij ankimi, kjo kërkesë nuk është reflektuar as në specifikimet teknike as në zërat e shërbimit.

Për këtë arsye, KSHA gjykon se me qëllim mundësimin e një gare të rregullt si me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës ndërmjet Operatorëve ekonomik, kërkesa e implementuar në DT, kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.7 duhet të hiqet.

Per sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit "REJ" shpk mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.2 me argumentimin se: Nisur nga zërat e shërbimeve të prokuruar dhe të kërkuara në dokumentet e tenderit nuk është kërkuar të kryhet shërbimi i mbetjeve të bidegradueshme nga kuzhinat dhe mensat sipas kodit 6-shifror 20 01 08; nuk është kërkuar të kryhet shërbimi i mbetjeve të biodegradueshme sipas kodit 20 02 01 si dhe nuk është kërkuar kryerja e heqjes së llumrave nga gropat skeptike sipas kodit 20 03 04...", KSHA arsyeton se: ...

*Duke qenë se kërkesa për disponimin e jo më pak se 20 tualeteve portative është vlerësuar si e pajustifikuar dhe e palidhur me objektin e kontratës, KSHA argumenton se për të njëjtat arsye rezulton e pajustifikuar edhe kërkesa për disponimin e kodit **20 03 04** në licensën III.2.B lëshuar nga QKB.*

Për këtë arsye, me qëllim garantimin e një gare të rregullt dhe nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomike, Komisioni gjykon se kërkesa e parashikuar në Dokumentet e Tenderit, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.2 në lidhje me disponimin e kodit 20 03 04 në licensën III.2.B, duhet të hiqet.

Per sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

II.6. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.6, KSHA vëren se:..

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues se: "...Kërkesa për disponimin e 2 (dy) autohote uji i pajisur me pompe thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të ozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre. me kapacitet mbajtës 2,000-3,000 litra; - 1 (një) autobot uji i pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompe lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 1,000 litra nuk është proporcion të drejtë me objektin e kontratës, pasi referuar zërave të shërbimeve të kërkuara nuk parashikohet askund as si shërbim në specifikime por as dhe si zë për ofertim pastrimi i tualeteve portative, thithje me vakum apo pastrim me pompë lavazhi i tualeteve portative...", KSHA gjykon se:

Referuar legjisllacionit për prokurimin publik në fuqi kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës si dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. Këto kritere duhet të jenë të përcaktuara në mënyrë të tillë që t'u mundësojnë Operatorëve ekonomik pjesëmarrës përgatitjen e ofertave në mënyrë sa më të krahasueshme. Gjithashtu kriteret e veçanta për kualifikim shërbejnë që Autoriteti Kontraktor të njihet me gjendjen dhe kapacitetet reale të Operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të

paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të natyrës dhe llojit të kontratës, Autoriteti Kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim Dokumentet e Tenderit të publikuara për procedurën objekt ankimi, konstatoi se në Formularin e Specifikimeve Teknike (Shtojca 6) nuk është parashikuar asnjë specifikim tekniko-funksional, kërkesë operative apo metodologji në lidhje me tualetet portative. Gjithashtu, në Grafikun e Ekzekutimit të Shërbimeve (Shtojca 7) nuk është evidentuar asnjë zë shërbimi që lidhet me instalimin, stacionimin apo mirëmbajtjen e tyre në zonat bregdetare.

Në këto kushte, duke qenë se kërkesa për disponimin e jo më pak se 20 tualeteve portative është vlerësuar si e pajustifikuar dhe e palidhur me objektin e kontratës, KSHA argumenton se për të njëjtat arsye rezulton e pajustifikuar edhe kërkesa për disponimin e mjeteve mbështetëse për funksionimin e tyre, konkretisht kërkesa e parashikuar në DT për disponimin e:

2 (dy) autobote uji i pajisur me pompe thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës 2,000-3,000 litra;

I (një) autobot uji i pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 1,000.

Për këtë arsye, me qëllim garantimin e një gare të rregullt dhe nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, Komisioni gjykon se kërkesa e parashikuar në Dokumentet e Tenderit, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.6 në lidhje me mjetet autobot uji të pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrim /dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre duhet të hiqet.

Per sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

II.7. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.4, me arsyetimin se:

"...Numri i kërkuar i shoferave nuk është në përpjestim të drejtë me numrin e mjeteve të kërkuara në pikën 2.3.6 dhe për këtë arsye duhet të modifikohet në përputhje me mjetet e kërkuara..." KSHA gjykon se: ...

Ndodhur në kushtet ku KSHA ka argumentuar heqjen e kërkesës së parashikuar në DT në lidhje me mjetet autobot uji të pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, argumentojmë se Autoriteti Kontraktor duhet të rishikojë dhe njëherë kërkesën në lidhje me numrin e punonjësve shoferë, në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet modifikimit në lidhje me mjetet e kërkuara.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", (1 ndryshuar), dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik "REJ" shpk....

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

a) pranimin e plotë të ankesës;

b) pranimin e pjesshëm të ankesës;

c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i vendimit të autoritetit kontraktor nr.67/2026, datë 04.05.2026 konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik “Rej” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr.1284 prot., datë 27.04.2026, të operatorit ekonomik “Rej” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik për të cilin pretendon se *nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 41/3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke kërkuar që kjo kërkesë të modifikohet në përputhje të plotë me parashikimet e pikës 3 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*, KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç
-) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik

Ndërsa në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.3 Në nenin 77 pika 1, 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3.Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.4. Në nenin 41, pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³⁹ ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimi .

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislationit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.2.6. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK të paraqitura në ankesë për kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitet teknik, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për vlerën limit të kontratave të ngjashme të realizuara është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të *lex specialis* si dhe nenit 41 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, që për të verifikuar përmbushjen e aftësive teknike të mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor të kërkojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit ku në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Nga verifikimet rezulton se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik në lidhje me vlerën limit të kontratave të ngjashme të kryera nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 42 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në lidhje me vlerën limit të kontratave të ngjashme sipas parashikimeve të nenit 41 pika 3 të aktit nënligjor të mësipërm, duke përcaktuar një vlerë brenda diapazonit të parashikuar në këtë dispozitë.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket kriterit 2.3.2 të kapacitetit teknik për të cilin pretendon se: “[...] Nisur nga zërat e shërbimeve të prokuruar dhe të kërkuara në dokumentat e tenderit, ballafaquar me përshkrimin e kodeve 6-shifrore që duhet të përmbajë licenca me Kod III.2.B, e kërkuar në pikën 2.3.2 të DT-ve, nuk rezulton asnjë përputhje, pasi nuk është kërkuar kurësi të kryhet shërbimi i mbetjeve të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat sipas sipas kodit 6-shifror 20 01 08, nuk është kërkuar të kryhet shërbimi i mbetjeve të biodegradueshme sipas kodit 20 02 01 si dhe nuk është kërkuar kryerja e heqjes së llumrave nga gropat septike sipas kodit 20 03 04. Për aq kohë sa një shërbim i caktuar nuk është kërkuar të kryhet dhe sigurisht as nuk është kërkuar që të ofertohej nga operatorët ekonomik, sigurisht që dhe caktimi apo kërkimi i licences III.2.B që të përfshijë dhe 3 kodet gjashtë shifror të cituara më sipër është totalisht i paligjshëm [...] ”, KPP vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit “Kapaciteti teknik” pika 2.3.2 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licence lëshuar nga QKB për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B, dhe duhet të disponojnë kodet si më poshtë:

- 20 01 08
- 20 02 01
- 20 03 04

III.3.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

Argumentimi Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke siguruar kështu AK që shërbimi do të kryhet nga operatorë të cilët disponojnë kapacitetet profesionale për kryerjen e këtij shërbimi, brenda standarteve.

Lloji dhe kategoria e licencës së kërkuar, duke përfshirë edhe kodet që duhet të disponojë kjo licencë, është vendosur nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues. Ky kriter bazohet në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, nenin 68 Ligjin Nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, pasi licenca me (kodin III.2.B dhe kodet që duhet të disponojë (20 01 08, 20 02 01, 20 03 04) është në përputhje me zërat e realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike, ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane në venddepozitimet përkatëse.

III.3.3.Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3, Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.5. Në seksionin “Kategoria III.2. “ Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis ” , nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

III.3.6. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht:

“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”.

Ky ligj përcakton:

a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”

III.3.7. Në shtojcën 1, pika 20 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 402, Datë 30.06.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, përcaktohet: 20 Mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas)

20 MBETJET URBANE (MBETJET SHTËPIAKE DHE TREGTARE, MBETJE INDUSTRIALE E INSTITUCIONALE TË NGJASHME) PËRFSHIRË FRAKSIONET E MBLEDHURA VEÇMAS

20 01 Fraksionet e ndara (përveç 15 01)

20 01 01 Letër dhe karton

20 01 02 Qelq

20 01 08 Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat

20 01 10 Veshjet

20 01 11 Tekstilet

20 01 13 * Tretësit

20 01 14 * Acidet

20 01 15 * Bazat

20 01 17 * Fotokimikatat

20 01 19 * Pesticidet

20 01 21 * Mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur

20 01 23 * Pajisje skarco që përmbajnë klorofluorokarbone

20 01 25 Vajra dhe dhjamëra ushqimore

20 01 26 * Vajra dhe dhjamëra, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 25

20 01 27 * Bojëra, ngjyra, ngjitës etj., që përmbajnë substanca të rrezikshme

20 01 28 Bojëra, ngjyra, ngjitës etj., të tjera nga ato të përmendura në 20 01 27

20 01 29 * Detergjent që përmbajnë substanca të rrezikshme

20 01 30 Detergjent të tjerë nga ato të përmendur në 20 01 29

20 01 31 * Medikamente citotoksike dhe citostatike

20 01 32 Medikamente të tjera nga ato të përmendura në 20 01 31

20 01 33 * Bateritë dhe akumulatorët të përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe bateritë e akumulatorët e pandarë

20 01 34 Bateritë dhe akumulatorët e tjerë nga ato të përmendur në 20 01 33

20 01 35 * Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21 dhe 20 01 23 që përmbajnë komponentë të rrezikshëm

20 01 36 Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21,
 20 01 23 dhe 20 01 35
 20 01 37 * Mbetje druri që përmbajnë substanca të rrezikshme
 20 01 38 Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37
 20 01 39 Plastikët
 20 01 40 Metalet
 20 01 41 Mbetjet nga pastrimi i oxhaqeve
 20 01 99 Fraksione të tjera të paspecifikuara
 20 02 Mbetje të kopshteve dhe parqeve (përfshirë mbetjet e varrezave)
 20 02 01 Mbetje të biodegradueshme
 20 02 02 Dhera dhe gurë
 20 02 03 Mbetje të tjera të pabiodegradueshme
 20 03 Mbetje të tjera urbane
 20 03 01 Mbetjet e përziera urbane
 20 03 02 Mbetje nga tregjet
 20 03 03 Mbetje nga pastrimi i rrugëve
 20 03 04 Llumra nga gropat septike
 20 03 06 Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza
 20 03 07 Mbetjet të vëllimshme
 20 03 99 Mbetjet urbane të paspecifikuara

III.3.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.3.9. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimit, ku të përfshihen ndër të tjera edhe grumbullimi transporti i mbetjeve urbane që kanë ndikim në mjedis. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se referuar dokumentit “*Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit*”, autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e shërbimeve si, Grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane, Pastrim i plazheve publike nga mbetjet, Larje dhe desinfektimi i

konteinereve. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër, KPP gjykon se gjatë kryerjes së shërbimit, referuar edhe parashikimeve të formularit të shërbimeve (shtojca 7), shfaqet kryerja e veprimtarisë së pastimit, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në vendepozitimet përkatëse Sa më sipër, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për licencim me Licencë Kodi III.2.B është në përputhje me natyrën dhe volumin e preventivit object kontrate.

Lidhur me pretendimet e ankimuesit për heqjen e kodeve 20.01.08 dhe 20 02 01, KPP vlerëson se, referuar zërave të shërbimit të kontratës objekt prokurimi, referuar kuadrit ligjor sektorial e konkretisht, VKM Nr. 402, Datë 30.06.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, në të cilin përcaktohet: **Kodi 20 01 08 Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat**, ndërsa **Kodi 20 02 01 Mbetje të biodegradueshme**, kërkesa e autoritetit kontraktor është e ekzagjeruar dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedure. Kodi 20 MBETJET URBANE përfshin një numër të kosideruëshëm kategori mbetjesh. Përcaktimi nga autoritetit kontraktor i dy kodeve të sipërpërmendura është diskriminues dhe e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të intereuar dhe përbën shkak për skualifikim të padrejtë të operatorëve ekonomikë në fazën e vlersimit të ofertave. Sa më sipër arsyëtuar Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit, duke hequr kërkesën për paraqitjen e aktmiratimit me kodet 20.01.08 dhe 20 02 01.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket kriterit 2.3.3 të kapacitetit teknik për të cilin pretendon se kërkesa e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), SSH UNI DIN EN ISO 39001 “Sistemet e Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” ose ekuivalente/të barazvlefshme, kushtëzon konkurrencën, si dhe nuk gjendet në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese të operatorëve ekonomikë për këtë procedurë prokurimi, duke kërkuar që kjo kërkesë hiqet, KPP vëren se,

III.4.1.Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit “Kapaciteti teknik” pika 2.3.3 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.3.Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

- SSH UNI DIN EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 9001 “Sisteme të menaxhimit të cilesisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;

- SSH UNI DIN EN ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 39001 “Sistemet e Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

III.4.2.Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.4.3. Në pikën 2 të nenit 41, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

Ndërsa në nenin 44, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.4.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e certifikatës *SSH UNI DIN EN ISO 39001 Sistemet e Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor ose ekuivalente/të barazvlefshme*, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga operatorët ekonomikë ofertues të kësaj certifikate është joproporcionale dhe jo e lidhur me natyrën dhe objektin e kontratës. ISO 39001 (SSH UNI DIN EN ISO 39001) është standard për sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor. Në procesverbalin për argumentimin e kriterëve kualifikuese autoriteti kontraktor ka justifikuar kërkesën lidhur me këtë certifikim si më poshtë: *“Standarti ISO 39001 “Sistemet e Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” ose ekuivalente/të barazvlefshme vlerësohet i nevojshëm, duke marrë në konsideratë se kontraktuesi për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, duhet të kryejë edhe procesin e transportimit të mbetjeve në venddepozitimet përkatës, përmes itinerareve të përcaktuara në rrugë publike. Transporti i mbetjeve realizohet në rrugë publike, duke u shoqëruar me përdorimin e mjeteve teknologjike të rënda, duke krijuar rrezik real për sigurinë rrugore, nëse ky proces do të kryhet nga ofertues të cilët nuk zotërojnë sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor, vecanërisht në sezonin e verës. Disponimi i këtij Standarti synon të garantojë menaxhimin efektiv të sigurisë në trafik përmes planifikimit të sigurt të itinerareve, kontrollit të realizimit të këtij procesi, trajnimit të drejtuesve të mjeteve dhe monitorimit të vazhdueshëm të rreziqeve. Disponimi i këtij standarti i shërben gjithashtu mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të qytetarëve, si dhe realizimit të kontratës në përputhje me standartet më të mira të sigurisë. “.* Komisioni vlerëson se siguria rrugore garantohej edhe përmes zbatimit të legjislacionit për qarkullimin rrugor, licencimin dhe kontrollin teknik të mjeteve, pajisjes së drejtuesve me lejet përkatëse të drejtimit etj. dhe jo domodoshmërisht me disponimin e këtij certifikimi. Në rastin konkret, KPP gjykon, se referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesat e autoriteti kontraktor për certifikatën *Standarti ISO 39001 “Sistemet e Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” ose ekuivalente/të barazvlefshme* nuk i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Kriteri i sipërpërmendur i vendosur nga

autoriteti kontraktor nuk është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, ndaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri të përcaktuar në dokumentat e tenderit si një kriter në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket kriterit 2.3.5 të kapacitetit teknik për të cilin pretendon se *Kërkesa për disponimin e 2 punonjësve të certifikuar Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë është e panevojshme. Do të mjaftonte vetëm një punonjës i certifikuar me një certifikatë të tillë për të përmbushur me sukses zbatimin e kontratës së kërkuar, aq me tepër që kemi të bëjmë me një kontratë shërbimi afati i të cilës është rreth 90 ditë. Sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri që nga 2 punonjës të certifikuar të kërkohej vetëm 1”, , KPP vëren se,*

III.5.1.Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.5 Operatori ekonomik, duhet të disponojë 2 (dy) punonjës të certifikuar “Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”,

Për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqitet dokumentacioni:

- Certifikatë (të vlefshme) për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, lëshuar nga autoritetet/institucionet e autorizuar;
- Kontratë pune (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.5.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Kriteri për këtë punonjës vendoset, bazuar në nenin 17 të ligjit 10237 datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, me qëllim që të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin, formimit të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre.

Numri dy lidhet me volumin e punimeve që do të kryhen, proceset e punës, si dhe duke vlerësuar faktin e përfshirjes së disa bashkive, në një lot. Në një kontratë të tillë, aktiviteti zhvillohet paralelisht në territore të ndryshme, me ekipe pune, mjete dhe procese të shpërndara në disa zona, duke e bërë të vështirë mbulimin nga një person i vetëm përgjegjës për sigurinë në punë. Prania e dy specialistëve siguron mbulim efektiv dhe të vazhdueshëm në terren, mundëson ndjekjen dhe kontrollin e sigurisë në cdo zonë, si dhe reagim më të shpejtë në rast incidentesh apo rreziqesh, që mund të ndodhin gjatë realizimit të proceseve të shërbimit. Kërkesa për 2 punonjës vlerësohet proporcionale me përmasën dhe shpërndarjen e kontratës, duke synuar garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, në të gjitha bashkitë ku do të kryhet shërbimi.

Disponimi i punonjësve në këtë kriter është vlerësuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues, dhe është përcjellë pranë OBP.

III.5.3. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Neni 3, Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti

kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.5.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.5.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket kriterit 2.3.5 të kapacitetit teknik për të cilin pretendon modifikimin e këtij kriteri, ku nga 2 punonjës të certifikuar të kërkohet vetëm 1, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ankimuesi nuk ngre pretendime lidhur me specialitetin apo profilin e punonjësve të kërkuar pra “Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, por kundërshton vetëm numrin e tyre, konkretisht kërkesën për disponimin e 2 (dy) specialistëve të tillë. Në lidhje me këtë pretendim, KPP konstaton se Autoriteti Kontraktor ka dhënë argumentim të detajuar mbi domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e numrit të kërkuar, duke referuar edhe bazën ligjore përkatëse, konkretisht nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 41 pika 4 shkronjat “b” dhe “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Referuar procesverbalit të argumentimit të këtij kriteri rezulton se autoriteti kontraktor ka argumentuar se kërkesa për 2 (dy) specialistë lidhet me volumin e shërbimeve, shtrirjen territoriale të kontratës dhe zhvillimin paralel të proceseve të punës në disa bashki njëkohësisht. Autoriteti Kontraktor ka sqaruar se aktiviteti do të realizohet në zona të ndryshme, me ekipe pune dhe mjete të shpërndara në terren, çka kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme të kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë. Në këto kushte, AK ka vlerësuar se një specialist i vetëm nuk do të siguronte mbulim efektiv dhe të mjaftueshëm për ndjekjen e zbatimit të masave të sigurisë në të gjitha zonat ku do të kryhet shërbimi. Gjithashtu, KPP mban në konsideratë faktin se kërkesa është mbështetur edhe mbi bazën e vlerësimit teknik të ekspertit të fushës, të kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Nga ana tjetër operatori ekonomik ankimues nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërisht se si përmbushja e këtij kriteri cënon konkurrencën. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor ka argumentuar nevojën për disponimin e 2 (dy) punonjësve të certifikuar “Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe se ky kriter rezulton në përpjesëtim me natyrën, volumin dhe shtrirjen e kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket kriterit 2.3.6 të kapacitetit teknik KPP vëren se,

III.6.1.Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.6 Operatori ekonomik, duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

- 5 (pesë) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton.
- 8 (tetë) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës 7-8 ton;
- 2 (dy) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës 5-6 ton;
- 3 (tre) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës deri në 1 ton;
- 3 (tre) Autobot Uji me kapacitet mbajtës jo më pak se 8000 Litra, i pajisur me pompë me presion për larje të ndryshme.
- 2 (dy) mjete teknologjike (skarrabel) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, inerte etj me ngarkim fundor ose anësor;
- 2 (dy) autobote uji i pajisur me pompe thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës 2,000 – 3,000 litra;
- 1 (një) autobot uji i pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 1,000 litra;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.6.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) autoriteti kontraktor ka argumentuar në lidhje me vendosjen e kriterit kualifikues të pikës 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9/2 “Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit, si më poshtë vijon:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të permbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme lidhet me proceset që duhet të kryejë ofertuesi për realizimin e shërbimit, objekt prokurimi, siç është: grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, larja dhe desinfektimi i konteinerëve.

Numri i mjeteve është përcaktuar nga eksperti i fushës, (i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për llogari të së cilit po kryhet prokurimi), i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe ka vendosur llojin dhe numrin e makinave/mjeteve, bazuar në nr. e konteinerëve, frekuencat dhe nr e turneve, të shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane, larjes dhe desinfektimit të konteinerëve. Përzgjedhja e llojit të mjeteve dhe kapaciteti mbajtës i tyre është bërë nga eksperti i fushës, në funksion të infrastrukturës apo trafikut të secilës zonë, të llojit të konteinerëve të parashikuar për tu tërhequr në secilën zonë, si dhe bazuar në llogaritjet e kryera nga eksperti, sipas VKM nr. 319 datë 31.05.2018 „Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve“, duke argumentuar si vijon:

Mjetet teknologjike (kompaktor) përdoren për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.

Autobotët e ujit min. 8,000 L me pompë presioni përdoren për larjen dhe dezinfektimin e kontejnerëve, shpëlarjen e zonës përreth PGM-ve dhe ndërhyrje higjieno-sanitare ndihmëse.

Skarrabelët përdoren për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve të shpërndara, inerteve të lehta dhe mbetjeve voluminoze që nuk trajtohen me efikasitet nga kompaktorët.

Autobotët vakum/lavazh 2,000–3,000 L dhe autoboti vakum/lavazh deri 1,000 L përdoren për tualetet portative, për thithje, larje dhe dezinfektim, sipas kushteve të aksesit në terren.

Cisternat e ujit min. 25,000 L dhe autobotët e ujit me sprucim shërbejnë për furnizim ndihmës me ujë dhe për shpëlarje/pastrim të sipërfaqeve të forta dhe segmenteve rrugore të ndotura.

Autobotet me kapacitet 8000 litra dhe 25000 litra,..., janë konsideruar si elementë mbështetës teknikë për garantimin e vijueshmërisë operative, rritjen e standardit higjieno sanitar dhe mbulimin efektiv të zonave të shërbimit, pa përbërë zëra të vecantë të koutuar në preventiv.

III.6.3. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar shprehimisht thuhet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Neni 41 pika 2 dhe 4, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: “2.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

III.6.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në

funkcion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *sa i përket numrit dhe tonazhit të mjeteve teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, si dhe numrit të autobot uji me kapacitet mbajtës jo më pak se 8000 litra i pajisur i pajisur me pompë për larje të ndryshme*, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka argumentuar dhe dokumentuar nevojën për përcaktimin e këtyre mjeteve në funksion të realizimit të shërbimit objekt prokurimi. Konkretisht, nga procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim rezulton se numri, lloji dhe kapaciteti mbajtës i mjeteve janë përcaktuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga autoriteti kontraktor, mbi bazën e një analize teknike të elementeve të shërbimit që do të kryhet. Referuar informacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor me shkresën nr.1844/13 prot., datë 21.05.2026, me objekt *”Mbi dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit me objekt ”Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” ndarë në lote*”, protokolluar me tonën me nr.1284/4 prot. datë 25.05.2026, Komisioni konstaton se eksperti i fushës në përcaktimin e mjeteve të kërkuara ka marrë në konsideratë një sërë faktorësh objektivë dhe të lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe përmasat e kontratës, si: numrin e kontejnerëve që do të shërbehen, frekuencën e grumbullimit të mbetjeve, numrin e turneve të punës, nevojën për larjen dhe dezinfektimin e kontejnerëve, karakteristikat infrastrukturore të zonave ku do të ofrohet shërbimi, intensitetin e trafikut. Gjithashtu, rezulton se eksperti i fushës për përlllogaritjet për përcaktimin e numrit dhe kapaciteteve të mjeteve është mbështetur në metodologjinë dhe treguesit e parashikuar në VKM nr. 319, datë 31.05.2018, *“Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”*, akt normativ i posaçëm që rregullon elementët teknikë dhe ekonomikë të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Nga ana tjetër, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur argumente teknike konkrete, nëpërmjet të cilës të provojë se numri ose kapaciteti i mjeteve të kërkuara është joproporcional, i panevojshëm apo kufizues që cënon konkurrencën. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për numrin dhe kapacitetin mbajtës të mjeteve teknologjike dhe numrin për autobot uji e për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk pranohet.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron

III.7.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket kriterit 2.3.4 të

kapacitetit teknik për të cilin pretendon se numri i kërkuar i Shoferave nuk është në përpjestim të drejtë me numrin e mjeteve të kërkuara në pikën 2.3.6 dhe për këtë arsye duhet të modifikohet në përputhje me mjetet e kërkuara dhe të rishikuara pas shqyrtimit të kësaj ankesë., KPP vëren se, në aktin e trajtimit të ankesës lidhur me këtë kriter KSHA ka pranuar pjesërisht pretendimin e ankimuesit duke argumentuar: “Ndodhur në kushtet ku KSHA ka argumentuar heqjen e kërkesës së parashikuar në DT në lidhje me mjetet autobot uji të pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, argumentojmë se Autoriteti Kontraktor duhet të rishikojë dhe njëherë kërkesën në lidhje me numrin e punonjësve shoferë, në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet modifikimit në lidhje me mjetet e kërkuara.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht

Në kushtet kur pretendimi i ankimuesit lidhur me mjetet e kërkuara në pikën 2.3.5 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, referuar arsyetimit në pikën III.6.4 të këtij vendimi nuk është pranuar, Komisioni vlerëson se edhe pretendimi i ankimuesit për uljen e numrit të shoferëve të kërkuar nuk pranohet.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit lidhur me këtë pikë nuk qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyll çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-82307-04-16-2026, me objekt: “Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” me fond limit 108,236,213.88 lekë (pa tvsh), planifikuar për tu zhvilluar me datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

